

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Aktiviteti 2.3.1.5: Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit, fokus i veçantë në SUT

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Søren Larsen,
Statistikat e Danimarkës

09-13 Mars 2015

IPA 2012

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk*

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e Përgjithshme	5
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	5
2.1 Projekti duket real.	5
2.2 Korniza e SUT e propozuar.	5
2.3 Outputi sipas produkteve në SUT.	6
2.4 Zgjedhja e klasifikimit të industrisë për prodhim, konsum të ndërmjetëm dhe komponentet e vlerës bruto të shtuar.	7
2.5 Klasifikimet e konsumit final.....	7
2.6 Distribuiimet fillestare sipas produkteve.....	8
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	8
Termet e Referencës:	11

Lista e Shkurtesave

ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar
LFS	Anketa e Fuqisë Punëtore
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUTs	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij misioni ka qenë analizimi i mundësive për të përpiluar Tabelat Ofruese-Përdoruese për vitin 2013 dhe i burimeve të të dhënave të nevojshme për këtë qëllim, që tashmë janë në dispozicion, ose janë planifikuar të jenë në dispozicion më vonë gjatë vitit 2015.

Gjatë misionit janë bërë disa aktivitete eksperimentale. Është krijuar një version i parë i klasifikimit të mundshëm të produkteve, që të përdoret në SUT, në bazë të statistikave të detajuara të TVSH-së për vitin 2013. Një numër produktesh me siguri do të hiqen duke pasur parasysh kufizimin nga disponueshmëria e të dhënave të nevojshme për hartimin e versionit fillestar të tabelës-përdoruese.

Është planifikuar të rregullohet një kornizë në Excel për SUT, sipas disa rregullave specifike. Statistikat e Danimarkës kanë zhvilluar një sistem në Excel macros, që mund të përdoret për futjen e të dhënave, balancimin dhe ekstraktimin e balanceve të produkteve, dhe strukturës së outputit dhe inputit- nga një kornizë të tillë.

Si provë, është koduar outputi i bujqësisë nga llogaritë kombëtare ekzistuese sipas klasifikimit të propozuar të produkteve dhe është bërë një format i standardizuar për futjen e të dhënave nga Excel-macros. Përveç kësaj, është analizuar se si burimet e tjera të të dhënave mund të kodohen dhe konvertohen në mënyrë të ngjashme. Është vërejtur në mënyrë specifike, që konsumi i ndërmjetëm tashmë është i klasifikuar sipas produkteve.

Është arritur në përfundim, që është e mundur të përpilohet SUT për vitin 2013, dhe që duhet të propozohet një plan kohor për këtë proces, para misionit të radhës. Plani kohor i propozuar është paraqitur si pjesë e këtij raporti.

Cilësia e SUT do të varet nga disponueshmëria e të dhënave për vitin 2013. Disa të dhëna të rëndësishme, ASN – dhe statistikat PRODCOM nuk pritet të jenë në dispozicion deri pas pushimeve verore. Përfundimisht orari i caktuar ndoshta mund të shtyhet varësisht se kur do të jenë të gatshme këto të dhëna.

Suksesi i projektit natyrisht do të varet nga stafi, që është në dispozicion në ASK, pasi do të ketë edhe punë për të bërë në periudhën midis misionëve. Eksperti danez së bashku me stafin e ASK-së do të definojnë detyrat, që duhet të bëhen para secilit mision të radhës.

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Në misionin e mbajtur me datën 21-23 Janar është vendosur të hulumtohen mundësitë për përpilimin e tabelave ofruese-përdoruese për vitin 2013, si pjesë e këtij projekti të binjakëzimit. Është vendosur që gjatë misionit aktual të bëhet një studim fizibiliteti për një projekt të tillë. Gjatë misionit duhet të realizohen disa prova të shndërrimit të burimeve ekzistuese të të dhënave në një formë të përshtatshme, që do të jetë si input në kornizën SUT, duhet të paraqitet një pasqyrë e burimeve aktuale të të dhënave në dispozicion dhe të diskutohet për nevojat për burime të tjera të dhënash. Nëse arrihet në përfundimin, që është i mundur realizimi, duhet të hartohet një plan kohor për SUT, për pjesën e mbetur të projektit.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Të analizohen burimet ekzistuese të të dhënave.
- Të theksohet nevoja për statistikë, që duhet të jenë të gatshme, para fazave specifike të projektit.
- Të shikohet mundësia e klasifikimeve të produkteve, industrive, grupeve të konsumit dhe përdorimeve të tjera finale, që duhet të definohen para se të krijohet korniza SUT.
- Të realizohet një kodim eksperimental sipas klasifikimeve të SUT të disa të dhënave, që tashmë janë në dispozicion në llogaritë kombëtare aktuale.

Ajo që pritet nga ky mision është një realist për përpilimin e SUT, përfshirë orarin për misionet e radhës.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunohen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partneri jonë i implementimit (NI-CO / Statistikat e Finlandës / Istat / Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Projekti duket real.

Misioni i mbajtur në Mars të vitit 2015 i është dedikuar shqyrtimit të mundësive për përpilimin e SUT për vitin 2013. Bazuar në ekperimentet me burimet e të dhënave në dispozicion, është arritur në përfundimin që është i mundur përpilimi i SUT për vitin 2013, në kuadër të projektit të binjakëzimit aktual. Orari i saktë, megjithatë, do të varet nga burimi i të dhënave në dispozicion, ndër të cilat më kritiket për momentin janë të dhënat mbi prodhimin sipas produkteve dhe industrive.

2.2 Korniza e propozuar e SUT.

Tabelat Ofruese-Përdoruese (SUT) për vitet 2005, 2006 dhe 2007 janë elaboruar më herët, por nuk janë bërë vlerësimet e azhurnuara. Megjithatë, preferohet që SUT për vitin 2013 të bëhet me metoda të reja bazuar në burimet e të dhënave që janë në dispozicion për këtë vit. Më pas do të bazohet në statistikave e klasifikuara sipas NACE rev.2 dhe CPA 2008.

Rekomandohet që korniza SUT të jetë në një format Excel, siç është zhvilluar nga Statistikat e Danimarkës. Kjo do të mundësojë futjen dhe nxjerrjen e të dhënave nga sistemi, si dhe macros për balancimin e ofrimit, përdorimit dhe rregullimit të qëllimeve për inpute, konsum final dhe përdorime të tjera finale. Macros të tilla janë zhvilluar në Statistikat e Danimarkës dhe janë përdorur për përilimin e SUT edhe në vende të tjera.

Në misionin e mbajtur në Janar, ekspertët kanë prezantuar shembuj të matricave ofruese-përdoruese. Është demonstruar se si duhet të përdoren burime të ndryshme statistikore për të mbushur pjesë të ndryshme të tabelës dhe është treguar që dimensionet e kornizës SUT mund të marrin parasysh disponueshmërinë e të dhënave dhe resurseve.

Sistemi SUT kërkon një definim të plotë të klasifikimeve për produktet, industritë, grupet e konsumit dhe nëngrupeve të formimit të kapitalit. Ato duhet të zgjedhen në atë mënyrë që marrin parasysh burimin e të dhënave në dispozicion dhe preferohet të kenë lidhje të mirë me klasifikimet zyrtare ndërkombëtare p.sh. CPA, NACE, COICOP ose COFOG.

Sistemi i ri do të kërkojë definimin e plotë të klasifikimeve të produkteve, preferohet në bazë të klasifikimit ndërkombëtar p.sh. CPA, por të agreguar në një numër produktesh, që mund të identifikohen në burimet e të dhënave të Kosovës. Klasifikimet e ngjashme të industrive, grupeve të konsumit dhe nëngrupeve të formimit të kapitalit duhet të zgjedhen në atë mënyrë që marrin parasysh burimin e të dhënave, që janë në dispozicion.

Përdorimi i plotë i kornizës së Excel kërkon që burimet e të dhënave të jenë në një format të standardizuar, duke përdorur klasifikimet mirë të definuara për llojet e transaksioneve të produkteve, industrive dhe përdorimit final. Duhet të definohen klasifikimet që do të përdoren në SUT pasi ato përcaktojnë dimensionet e tabelave në Excel. Inputet nga burimet e ndryshme statistikore me siguri do të jenë të gatshme të klasifikuara, sipas sistemeve të ndryshme të kodimit. Do të duhet të krijohen tabelat korresponduese midis këtyre klasifikimeve dhe klasifikimeve, që do të përdoren në SUT.

2.3 Outputi sipas produkteve në SUT.

Si në shumicën e vendeve të tjera, mund të supozohet që statistikë të tregtisë së jashtme janë të koduara sipas sistemit të harmonizuar, mjaftueshëm detajuar për ti agreguar në çfarëdo klasifikim produktesh të SUT.

Një problem specifik është mungesa e informatave mbi ndarjen e outputeve të industrisë, sipas produkteve. Prodhimi në bujqësi mund të gjendet në 'Llogaritë Ekonomike për Bujqësi' që përmban specifikacionet sipas produkteve të ndryshme bujqësore.

Për SUT për vitin 2013 do të duhen informacione së paku mbi:

- Vlerat për outputin Total
- Konsumin e ndërmjetëm
- Kompenzimin e punëtorëve

Për secilën industri që shfaqet si kolonë në SUT.

Pasi janë mbledhur pyetësorët e ASN-së për vitin 2013 janë paraqitur disa probleme, ndër të cilat:

- Shkalla e ulët e përgjigjeve e pazakontë në anketën e vitit 2013. Anketa është mbledhur gjatë pushimeve verore.
- Është reduktuar procedura e validimit, duke lënë shumë gabime të korrigjohen manualisht.
- Mund të supozohet që vlerat nga burimet statistikore janë nënvlerësuar në industritë me ekonomi të pavrojtuar.

Të dhënat për pyetjet, që nuk kanë marrë përgjigje, mund të gjenden në regjistrat administrative p.sh. regjistri i TVSH-së. Të dhënat e detajuara që mungojnë mund të gjenden në ASN për vitin 2012 ose 2014, ku së bashku me statistikën e TVSH-së mund të përdoren në vlerësimin e outputit dhe inputit total të këtyre njësive. Përndryshe të dhënat mund të imputohen duke u bazuar në njësitë, që kanë përgjigjet. Në disa industri, vlera e outputit mund të bazohet kryesisht në statistikën e TVSH-së.

Nëse supozohet që outputi për secilën industri 4-shifrore, që i përket një produkti specifik në SUT (e definuar si agregim i produkteve CPA), është e mundur të prodhohet një matricë ofruese mjaftueshëm e detajuar. Si shembull është bërë një klasifikim produkte bazuar në qarkullimin e TVSH-së për industrinë e detajuar. Në këtë mënyrë mund të dallohen rreth 370 produkte. Ky klasifikim me siguri është shumë i detajuar dhe disa produkte do të duhet të bashkohen pas krahasimit me klasifikimet e përdorura në burimin e të dhënave mbi strukturat e inputit, konsumit final të ekonomive familjare dhe konsumit të përgjithshëm të qeverisë.

Me siguri mund të supozohet që shumë industri përbëhen nga njësi të vogla, nga të cilat mund të nxirret vetëm një produkt i SUT. Ndërmarrjet më të mëdha janë në numër të vogël. Për ndërmarrje të tilla, madhësia e aktiviteteve sekondare mund të gjendet në ASN dhe ndarja e outputit total me siguri mund të bëhet në bazë të statistikave PRODCOM, me kusht që këto të jenë në dispozicion në kohën kur nevojiten. Si mjet i fundit, mund të jetë e mundur të mbledhen informata plotësuese nga ndërmarrjet më të mëdha dhe jo domosdoshmërisht të jenë nga viti 2013.

Është e rëndësishme të bëhet një plan për kalkulimin e totaleve të outputit dhe inputit. Këto vlera duhen për kolonat-totalet në SUT dhe balansimi nuk është i mundur pa vlerat e tilla.

2.4 Zgjedhja e klasifikimit të industrisë për prodhim, konsum të ndërmjetëm dhe komponentet e vlerës bruto të shtuar.

Zgjedhja e klasifikimit për kolonat e outputit-dhe inputit me siguri mund të limitohet në zgjedhjen midis 64-ose 86 industrive ose një kompromis midis këtyre dyjave. Derisa 86 industrinë korrespondojnë me NACE rev.2, 2-shifrore, klasifikimi 64 kërkohet nga Programi i Transmetimit i BE-së dhe për krahasimet ndërkombëtare në përgjithësi. Për qëllime të I-O mund të preferohet klasifikimi më i detajuar, por industrinë më pak të detajuar mund të jenë më të realizueshme, ku burimi i të dhënave është i pakët dhe i pasigurt.

2.5 Klasifikimet e konsumit final.

Vlerësimet fillestare të detajuara të përdorimit të produkteve për konsumin final të ekonomive familjare mund të merren nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare e vitit 2013. Anketa duhet të përdoret pas aplikimit të peshave në mënyrë që të mbulojë konsumin e popullsisë në tërësi.

Anketa është e klasifikuar sipas COICOP 5-shifror, që shumë lehtë mund të kthehet në produkte të SUT duke përdorur një tabelë korresponduese, pasi të jetë vendosur për klasifikimin final të produktit.

Në tabelën përdoruese të konsumit të ekonomive familjare duhet të paraqiten një numër kolonash për grupet e konsumit, ku secila përmban distribuimin e produkteve që i përkasin klasifikimit specifik të COICOP-it. Numri i grupeve të tilla të konsumit mund të jetë midis 12, që korrespondon me COICOP 2 –shifror (plus 2 kolona për konsumin e rezidentëve jashtë vendit dhe konsumit të jo-rezidentëve në territorin e brendshëm), por mund të ndahet edhe në

një numër më të madh të kolonave sipas COICOP, nëse ka burime të mjaftueshme në dispozicion.

Gjithashtu duhet të mendohet se si duhet të paraqiten konsumi final i NPISH dhe shpenzimeve qeveritare. Nënndarja e konsumit të qeverisë në kolona për grupet COFOG është e mundur si për konsumin individual, ashtu edhe atë kolektiv. Konsumi individual mund të paraqitet sipas grupeve COICOP. Një propozim real është paraqitja e konsumit qeveritar si kolona për grupet COFOG- 2-shifrore (=ndarjet).

Formimi i Bruto Kapitalit Fiks duhet të nënndahet sipas llojit të asetit fiks, në detaje siç kërkohet nga programi i transmetimit ESA 2010. Ndryshimet në inventar mund të paraqiten në kolonat për materialet, produktet finale, punën në progres dhe mallrat për tregti.

2.6 Distribuiimet fillestare të përdorura nga produktet.

Për bujqësi, inputet më të rëndësishme mund të gjenden në ‘Llogaritë Ekonomike të Bujqësisë 2013’. Mund të përdoren informatat nga ASN, edhe nëse mbulueshmëria nuk është shumë e kënaqshme. Gjatë misionit janë hulumtuar në veçanti të dhënat nga llogaritë qeveritare dhe është vërejtur që ato tashmë janë të koduara sipas llojit të produktit. Është e thjeshtë të bëhet një tabelë korrespondente midis këtij kodimi dhe kodeve të produkteve, që do të përdoren në SUT.

Në përgjithësi mund të supozohet që të dhënat në strukturat e inputeve të industrive pak a shumë janë të pakompletuara, por është e mundur të plotësohen këto mangësi duke përdorur informacione plotësuese nga vitet e tjera, nga vendet e tjera dhe, në shumë raste, nga vet analizimi logjik. Në fund, shumë inpute do të përcaktohen nga të dhënat ofruese në dispozicion për përdorim të brendshëm.

Për produkte specifike është e mundur të përcaktohet përdorimi i tyre si konsum i ndërmjetëm, konsum final i ekonomive familjare ose formimi i kapitalit nga karakteristikat e tyre. Kjo metodë e ‘rrjedhes së mallrave’ nuk është e sigurt kur produktet e njëjta zakonisht përdoren për më shumë se një nga këto përdorime. Prandaj preferohet që strukturat e produkteve fillestare të ndërtohen për të gjitha kolonat në anën e përdorimit, por gjatë procesit të balancimit zakonisht preferohet të bëhet përshtatja e vlerave, që janë më të pasigurta.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandohet që përpilimi i standardeve për SUT të bëhet pasi të rregullohet sistemi për prodhimin e shifrave tremujore. Pasi të dhënat nga ASN dhe anketa e bujqësisë nuk pritet të jenë të gatshme deri pas gjysmës së dytë të vitit 2015, për fillimin e aktivitetit rreth SUT duhet të priten këto burime. Po ashtu është shumë e rëndësishme që personat, që do të punojnë në këtë aktivitet, të jenë në dispozicion gjatë periudhës, në të cilën planifikohet të realizohet ai. Megjithatë, është e mundur të punohet në definimin e rreshtave dhe kolonave për SUT, para se të jenë në dispozicion të dhënat aktuale, dhe po ashtu duhet të jetë e mundur të rregullohen tabelat korresponduese midis kodimit të burimit të të dhënave dhe kodimit, që do të vendoset të të përdoret në SUT.

Propozimi për orarin kohor për misionet lidhur me Tabelat ofruese-përdoruese SUT mund të përfshijë 6 misione të tjera përveç misionit aktual, secili në kohëzgjatje prej një jave:

Plani i propozuar për aktivitetet në 2015/2016

	Koha	Çështjet më të rëndësishme
1	Mars 09-13 2015 (misioni aktual)	Misioni i gjetjes së fakteve
2	Qershor 22-26 2015	Klasifikimet, tabelat korresponduese dhe kodimi i burimit të të dhënave.
3	Në fillim të Shtatorit 2015	Futja e të dhënave, distribuimi i taksave, marzhat e tregtisë dhe transportit.
4	Në mes ose në fund të Tetorit 2015	Balancimi i anës ofruese dhe përdoruese për secilin produkt.
5	Në mes ose në fund të Nëntorit 2015	Përshtatjet për inputet e industrisë dhe përdorimet finale
6	Mesi i Janarit 2016	Balancimi final i marzhave, taksave dhe TVSH, ndarja e GVA, tabela simetrike I-O.
7	Shkurt 2016	Çështjet e pazgjidhura. Prezantimi i versioneve finale të rezultateve. Propozimet për punën në të ardhmen.

Puna më e madhe do të duhet të kryhet në periudhat midis misioneve dhe suksesi i projektit do të varet nga resurset në ASK, që janë në dispozicion për këtë qëllim. Gjatë secilit mision do të bëhet një përshkrim i detyrave specifike, që duhet të kryhen para misionit të radhës.

Hapi i parë do të jetë bërja e kornizës së SUT në Excel. Kjo kërkon një përzgjedhje të klasifikimit për produktet, industritë, grupet e konsumit dhe përdorimet e tjera finale, që do të përcaktojnë madhësinë e sistemit SUT. Ato duhet të përzgjedhen duke marrë për bazë disponueshmërinë e burimit të të dhënave dhe, mundësisht, klasifikimet zyrtare ndërkombëtare p.sh. CPA, NACE, COICOP ose COFOG. Pasi të merret ky vendim, mund të krijohet kornizë ‘e zbrazët’ e SUT.

Para se të plotësohet me të dhëna korniza SUT, duhet të hartohen tabelat korresponduese në mes kodeve të përdorura në burime të ndryshme të të dhënave dhe klasifikimeve të përdorura për rreshtat dhe kolonat në SUT.

Disa burime të të dhënave, siç janë ASN dhe statistikave PRODCOM, që përdoren për përlogaritjet e pjesës ofruese, duhet të jenë në dispozicion para se të plotësohet korniza Excel me të dhëna aktuale, që është planifikuar të ndodh në Shtator 2015.


Burimet e të dhënave duhet të jenë në një format të standardizuar dhe të agregohen në klasifikimet e SUT, para se të futen në kornizën e SUT. Rekomandohet që praktikisht e gjithë futja fillestare e të dhënave të përfundojë para misionit të planifikuar në Tetor. Realisht disa probleme të pazgjidhura ndoshta duhet të analizohen gjatë fillimit të balancimit në këtë mision.

Balancimi i balanceve të produkteve dhe balancimi final i marzhave të tregtisë, taksave dhe TVSH-së mund të kërkojë së paku dy misione, por kjo natyrisht do të varet nga madhësia dhe detajet e SUT, si dhe nga cilësia e të dhënave, që futen fillimisht në sistem.

Pasi të përpilohet një sistem i plotë i balancuar SUT, mund të përpilohet një tabelë simetrike e Inputit-Outputit. Kjo planifikohet të fillojë gjatë misionit në Janar.

Është e nevojshme që personat, që punojnë në SUT, të kenë kohën e mjaftueshme për këtë. Është jo të mendohet që futja e të dhënave në kornizën e SUT mund të fillojë para pjesës së dytë të vitit 2015.

Orari kohor i propozuar varet nga disponueshmëria e të dhënave, kur ato nevojiten. Në disa raste mund të gjenden mënyra të tjera alternative për të vlerësuar pjesë specifike të matricës ofruese. Megjithatë, mund të jetë e nevojshme të pritët për informata të tjera të rëndësishme, dhe në raste të tilla disa misione të planifikuara mund të shtyhen.



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahja për Statistika

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.3.1.5: Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit. Fokus i veçantë në SUT

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 20 Shkurt 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 9-13 Mars 2015

Koha e raportimit: 20 Mars 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi logjikë	Pikë referimi	Burimi i informacionit	Sygjerimet
2.3.1	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raportet e misioneve, të publikuar në faqen e internetit të projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare, të përditësuara sipas ESA2010	- Raportet tremujore të projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i përditësuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e dytrave, që lidhen me projektin në mes të misioneve - Qasje në statistikat primare të sakta - Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.3.1.5

Përkrahja në përpilimin e llogarive kombëtare në Kosovë. Fokus special në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdimësi e misionit me Gravesen, Ivan-Ungureanu dhe Larsen. Do të jetë mision dedikuar gjetjes së fakteve, me qëllim primar hulumtimin e mundësisë së përpilimit të tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT) për Llogaritë Kombëtare në Kosovë.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.1.1:

Raporti i misionit, që përshkruan disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për SUT në të ardhmen

Përshkrim i punës së bërë gjatë misionit dhe punës që duhet bërë para fillimit të aktiviteti të radhës

Stafi i ASK-së:

Znj. Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rksgov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapi, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA), i përgatitur nga Eurostat-i, deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK-ja, me mbështetjen e IPA-s, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërfshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare, së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimi ka pasur deri tani 7 aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare:

Gjatë misionit të kaluar ASK dhe eksperti kanë gjetur që ndoshta është e mundur të përpilohet SUT për Llogaritë Kombëtare në Kosovë. Ky mision do të hulumtojë nevojat për burimet e të dhënave dhe mundësitë për përmbushjen e këtyre nevojave me qëllim që të merret vendimi nëse ky aktivitet është i realizueshëm.

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e misionëve të kaluara në komponentin e LLK. Të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare me SUT
- Zhvillimi i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT nga programi i binjakëzimit

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportimin
- Plani i detajuar për aktivitet të më tej, të kompletohet në komponentin 2 nga programi i binjakëzimit
- Versioni i azhurnuar i Planit të Veprimit të Llogarive Kombëtare, përfshirë mundësinë dhe orarin për SUT të gatshëm për tu marr në konsideratë nga menaxhmenti i lartë i ASK-së.

Aneksi 1. Programi, Mars 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i punës së bërë nga misioni i kaluar mbi LLK në Nëntor 2014
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	VA: Prezantimi i SUT
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	VA: Korniza e Excel për SUT dhe të dhënat e nevojshme. Planifikimi i javës në vazhdim
2	ASK	09:00-16:00	Seminar/diskutime Disponueshmëria e të dhënave. Çka dhe kur? Çfarë niveli detajesh? Përpjekja e parë për të përcaktuar madhësinë e kornizës SUT për Kosovë.
3	ASK	09:00-16:00	Seminar/diskutime Organizimi i punës: Struktura e drejtorive dhe dosjeve. Format i standardizuar për inputet e të dhënave. Përgjegjësitë për personat e involvuar.
4	ASK	09:00	Diskutime të mëtejme mbi qasjet e ndryshme për SUT: Një model real për kornizën e SUT në Excel. Vlerësimi i nevojës për resurse dhe misione të ardhshme.
		10:30	Pushim për kafe
		10:45	Diskutimi për orarin për punën në të ardhmen Diskutimi mbi rekomandimet
		12:00	Dreka
		13:30	Shkrimi i raportit
5	ASK	10:00	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA
		10:30	Shkrimi i raportit